



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 17.07.2019, ora 16.00

Drejton mbledhjen -

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

Shqyrtimi i rasteve për gjetjet e deritanishme, në procedurën e verifikimit të disa prej kandidatëve për vendet vakante për Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|----------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 7. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 8. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni 232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm :

1. Enio Haxhimihali, përfaqësues i Avokatit të Popullit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kuvendit.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Shqyrtimi i rasteve mbi gjetjet e deritanishme në procedurën e verifikimit të disa prej kandidatëve për vendet vakante Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me shqyrtimin e e gjetjeve për rastet e kandidatëve që janë kandiduar për vende vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon mbledhjen se sipas komunikimeve me Avokaten e Popullit, e cila nuk merr pjesë në këtë mbledhje për arsye të një shërbimi zyrtar, ka bërë një observim se dokumentacioni që i është dërguar nuk është i plotë, ndonëse nuk është rasti që të pengohet vijimi i mbledhjes për ditën e sotme. Këshilli do të mbajë parasysht këtë njoftim për rastet që do të pasojnë për të dërguar dokumentacion më të plotë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Arta Vorpsi.

Arta Marku, parashtron relatimin për kandidaten Arta Vorpsi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se në lidhje me kandidatën nuk është se kemi ndonjë mendim të veçantë. Po ashtu, siç u evidentua, kemi pasur vetëm relacionin në dispozicion për të verifikuar saktësinë e materialeve mbi të cilat është mbështetur relacioni. E kemi të pamundur të japim një opinion. Kështu që rezervojmë të drejtën për të dhënë një mendim për këtë candidate.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Arta Vorpsi.

Vitore Tusha, parashtron relatimin për kandidaten Arta Vorpsi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se i mbetemi të njëjtin qëndrim.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Arta Vorpsi.

Fatri Islamaj parashtron relatimin për kandidaten Arta Vorpsi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se i mbetemi të njëjtit qëndrim që dhamë në fillim të mbledhjes.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Fatjona Memçaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Arta Vorpsi.

Fatjona Memçaj parashtron relatimin për kandidaten Arta Vorpsi për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtro se kemi të njëjtin qëndrim.

Ardian Dvorani përpara se të kalohet tek kandidati tjetër sipas kërkesës i jepet fjala zotit Bledar Dervishaj.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe lidhur me relacionet shtron pyetjet se lidhur me kushtin e parashikuar nga ligji që kandidati të mos ketë ushtruar 10 vitet e fundit veprimatri politike, kur flasim se i është drejtuar kërkesë KQZ-së dhe partive politike, Këshilli i është drejtuar të gjitha partive politike apo KQZ-së? Në cilësinë e nivelit drejtues apo sipas statutit të tyre?

Ardian Dvorani shpjegon se kërkesa e Këshillit i është drejtuar së paku 17 partive politike. Informacioni u është kërkuar nëse kandidatët kanë pasur funksione drejtuese në partinë politike por nuk komentojmë paraprakisht lidhur me statutet e tyre përkatëse. Bashkëlidhur shkresës standarde drejtuar secilës parti politike, është bashkëlidhur edhe lista e kandidatëve.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidates Elsa Toska.

Vitore Tusha, parashtro relativimin për kandidaten Elsa Toska për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtro se janë tre çështje, jo për rastin konkret, por në parim gjithmonë. Dokumentacionin sot e morëm dhe nuk mund të shprehemi për kandidatët. Por në parim, lidhur me procedurën, vetë mënyra se si hartohet një relacion, në vlerësimin tonë mbase ka nevojë për tu diskutuar sepse ka thjesht konstatime. Relacioni është hartuar në disa kre, kapituj si procedura e verifikimit, gjetjet mbi procedurën e verifikimit. Por realisht nuk është tamam kështu. Neni 37 i vendimit nr.4 për procedurën e verifikimit përcakton se kryetari fton relatorët të paraqesin përmbledhjen e procedurave, fakteve dhe gjetjeve. Tani, në relacione nuk ka analizë. Relacioni thjesht bën një përshkrim të fakteve. Gjetjet janë analizë. Tek rasti konkret p.sh për ta ilustruar, sepse kështu janë pak a shumë të gjitha, vetëm në një rast në pikën 46 thuhet se Këshilli konstaton se kandidatja nuk ka ushtruar funksione politike. Pra, vetëm në një rast ka konstatim. Edhe në një rast tjetër, në pikën 35 ku thuhet se KED

verifikoi përputhshmërinë e të dhënave etj, por nuk thuhet se çfarë konkludohet. Pra, në vlerësimin tonë, mos mbase ka nevojë që të shterohet. Pra, për analogji një këshilltar kur bën raportimin për një rekurs në Gjykatën e Lartë, bën analizën e fakteve dhe del me një konkluzion, ndërsa këtu nuk dilet fare në konkluzion. Të vetmet pikat 35 dhe 47, nëse nuk gaboj 46, vetëm në një rast thuhet që Këshilli konstaton. Në të gjithë pjesën tjetër të raportit për çështjet për shqyrtim në mbledhjet e KED-së nuk dilet në asnjë analizë, në asnjë konkluzion.

Çështja e dytë ka të bëjë me personin konkret, i cili ka kaluar në datën 12.02.2019 Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Pyetja jonë është, gjithë hetimi administrativ i KED që është bërë për këtë kandidatë është për periudhën post vetting apo përfshin edhe periudhën para vettingut?

Dhe e treta, në pikën 6, ka një lapsus, ka një gabim në shkrim. Pavarësisht se relatori është tjetër duke qenë se janë 4 relacione për të njëjtin kandidatë, mbase është bërë gabim sepse në short relatores është zonja Fatjona Memçaj, në një kohë që relatores është zonja Vitore Tusha.

Vitore Tusha, në cilësinë e relatores, shpjegon dhe sqaron se forma e ndjekur nga KED për të bërë raportimin është korrekte. Në të është prezantuar e gjithë procedura e ndjekur për kandidaten. Gjithë komunikimi me të personalisht dhe me institucionet dhe janë hedhur për secilin kusht ligjor dhe fakt që është kërkesë e ligjit, pra janë të gjitha gjetjet që kanë rezultuar. Nëse ju mendoni që unë si relatores duhet ta shpreh në këtë moment çfarë mendimi dhe qëndrimi kam, kjo është shumë e diskutueshme. Atë do ta shpreh në momentin kur ne të mbledhemi për të vendosur. Por mendimi im nuk është se i intereson në këtë moment askujt. Do të interesohej në momentin kur vendimi do të merret dhe mendimi im ashtu si i gjithë Këshillit do të arsyetohej. Mendoj që është korrekt relacioni ose metoda e ndjekur meqenëse ju e bëtë në parim pyetjen për formatin e raportit. Nuk është një detyrim që paraprakisht relatori të tregoj se çfarë mendimi ka. Është tjetër gjetja të themi e një natyreë kategorike. Ndryshe janë gjetjet p.sh që ka ILDKPI-ja apo institucione të tjera. Në raportin janë vendosur si gjetjet e Institucionit, ashtu edhe shpjegimet dhe komentet e bërë nga kandidati. Në këtë mënyrë ka gjithë secili mundësinë për të dhënë mendime, qoftë ne si anëtar, qoftë edhe ju të na vëzhgoni.

Lidhur me pyetjen tjetër. Kontrolli është bërë pa vënë fare në dyshim atë të vettingut dhe prandaj u raportua edhe vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ne për atë periudhë nuk kemi bërë kontroll të detajuar dhe të thelluar për këtë kandidatë. Procedura e ndjekur dhe plotësimi i dokumentacionit ka qenë për periudhën më pas. Ndërkohë çdo e

dhënë që merret mund ti shërbejë verifikimit sepse ne nuk kemi një kufizim në qoftë se do të kishim një të dhënë që do ti shërbejë këtij procesi.

Ardian Dvorani, në cilësinë e anëtarit dhe Kryetarit të Këshillit, merr falën dhe shpjegon se kjo del edhe nga raportet e kontrollit të ILDKPKI. P.sh për kandidatët që kanë kaluar Vetingun është bashkëlidhur Raporti i ILDKPKI dhe Deklarata e Pasurisë për Vetingun dhe pastaj Raporti i ILDKPKI aktual me një analizë ekstra në procedurën aktuale të verifikimit të pasurisë. Madje nuk ia kemi kërkuar ne të veprojë kështu. Ne i kemi çuar listën e kandidatëve në mënyrë që ai të vlerësonte vetë, a do të ushtronte kontroll apo jo? Vërejmë se Inspektoriati ka analizuar vetë, kryesisht, periudhën nga 1 Janar 2017 e prapa, kurse për periudhën përpara ka bashkëlidhur raportin e kontrollit referuar dokumentacionit të marrë dhe që e ka depozituar në kuadër të Vetingut. Edhe në lidhje me kontrollin e integritetit përgjithësisht bazohemi në vendimin e KPK. Por ka edhe disa raste, si psh kërkesa për informim që i bëjmë autoritetit të dosjeve sepse nuk është objekt i verifikimit nga organet e Vetingut. Po kështu kur i drejtohem me kërkesë për informacion Prokurorisë së Përgjithshme i sjellim në vëmendje që kandidatja me vendimin përkatës të formës së prerë është konfirmuar në detyrë. Pra ia sjellim në vëmendje, pastaj autoriteti e di vetë se çfarë bën. Kjo është ajo që ka ndodhur dhe rastin e zonjës Toska. ILDKPKI ka evidentuar dy problemet e mëparshme, si edhe dy probleme ekstra sipas tyre. Prandaj edhe kandidatja ka bërë objeksionet e saj se i ka deklaruar njëherë dhe është mbyllur kjo histori. Ndërsa për problemeekstra pretendon se nuk qëndrojnë apsi ka referuar që edhe atë janë deklaruar në vetting. Të gjithë këtë informacion e gjeni në dokumentacionin që keni në dispozicion në CD-në përkatëse. Lidhur me kontrollin e pasurisë, sipas ligjit, nëse ka pasur kontroll të thelluar, apo kontroll vetingu, nuk je i detyruar të bësh kontroll të dytë të thelluar, por kjo nuk përjashtohet. Ka 2 raste përjashtimore. Nëse kanë kaluar 180 ditë, kontrolli i thelluar duhet të bëhet dhe në qoftë se ka indicije të tjera, organi mundet ta bëj kontrollin e thelluar edhe kur nuk kanë kaluar 180 ditë. Gjithsesi ILDKPKI ka bërë kontrollin e plotë për periudhën pas datës 31 dhjetor 2016 deri në të cilën shtrihej kontrolli i vetting-ut. Për periudhën përpara po kuptojmë që e marrë të mirëqenë analizën e parë sepse nuk ka patur ndonjë indicie. Kështu që vërtet kemi vendime të KPK të formës së prerë por nuk kemi ndonjë lloj imuniteti, pra të jemi përgjithmonë jashtë kontrollit sepse mund të zbulohet edhe ndonjë gjë që nuk ishte evidentuar më parë. Ne nuk i kemi ndërhyrë organeve përkatëse edhe ILDKPKI, edhe Prokurorisë së Përgjithshme etj. për ti thënë se për çfarë je i detyruar ta verifikosh kandidatin. Secili e di ligjin vetë. Përtej verifikime tona, ne kemi për detyrë të vetëm të komunikojmë dhe të përcjellim kërkesat për informacion, të tjerët duhet të bëjnë detyrën të zbatojnë ligjin.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Elsa Toska.

Arta Marku, parashtron relatimin për kandidaten Elsa Toska për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se kam të njëjtin qëndrim.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Fatri Islamaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Elsa Toska.

Fatri Islamaj parashtron relatimin për kandidaten Elsa Toska për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se ka të njëjtin qëndrim edhe në këtë rast.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatores Fatjona Memçaj të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Elsa Toska.

Fatjona Memçaj parashtron relatimin për kandidaten Elsa Toska për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se kam të njëjtin qëndrim.

Ardian Dvorani përpara se të kalohet tek kandidati tjetër, sipas kërkesës, i jep fjalën zotit Bledar Dervishaj.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe shprehet se ajo që ngriti përfaqësuesi i Avokatit të Popullit mendoj që se jo se nuk qëndron, por mendimi i relatorit për çdo vakancë, për çdo kandidat është i shprehur tani, edhe pse nuk është i arsyetuar hollësisht, por i shprehur është. Përderisa thotë që nuk ka kushte ndalimi, një lloj vullneti relatori e shpreh përpara Këshillit. Por gjithmonë është paraprak që do të diskutohet në Këshill. Ndërsa për shqetësimin që

ngriti për sa i takon përmbajtjes së arsyetimit mbi element të caktuar të vlerësimit ekonomik, financiar etj., ai ka të drejtë, për arsye se duket sikur Këshilli nuk po merr parasysh një rekomandim të ILDKPI-së në këtë rastin konkret. Ndoshta në momentin që ju do ta diskutoni dhe do ta zbardhni në vendimin tuaj, pro apo kundra, ç'ëndësi ka, duhet të gjejë një arsyetim më shterues që ai të bindi Avokatit e Popullit, kandidatët dhe institucionet pritëse pse u bë ky vlerësim. E për të vazhduar më tej, do të kërkoja vëmendjen e Këshillit edhe për kushtin sa i takonte 15 vjet eksperiencë në punë, pra për një arsyetim më shterues mbi këtë kusht, plotësohet ose jo nga kandidatët. Por që kërkon e meriton vëmendje krahasuar dispozitës dhe rrjedhshmërisë së karrierës së këtij kandidati.

Ardian Dvorani shpjegon se vendimet tona në fakt do të jenë të arsyetuara për çdo gjetje, edhe aty ku mund të ketë një "nuhatje" ka arsyetim për të bërë, por që ka edhe një konkluzion. Edhe në këtë rast konkret do të ketë një arsyetim midis dy përballjeve, hetimit të Inspektorit dhe hetimit që kemi bërë ne dhe shpjegimeve që ka dhënë kandidati, duke bërë një analizë dhe arsyetim në ditët e ardhshme.

Enio Haxhimihali kërkon fjalën dhe shprehet se për ta sqaruar dhe një herë pyetjen që në bëmë se nuk ishte tamam ashtu siç tha përfaqësuesi i Presidentit. Ky shqetësim që ne ngritëm në këtë mbledhje lidhet me një shqetësim tjetër të ngritur në mbledhjet e mëparshme ku ne jemi përjashtuar, në vlerësimin tonë pa të drejtë, nga momenti i diskutimit. Pra institucioni i Avokatit të Popullit është për të garantuar transparencën. Në momentin që nuk shprehet në relacion, në momentin kur ne jemi të përjashtuar nga dhoma e këshillimit, atëherë si mundet Avokatit të Popullit të shprehë dhe mund të parashtrojë mendimet e vlerësimit vetëm për mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit kur nuk e ka këtë informacion. Pra teorikisht kandidatit mund ti mohohet një e drejtë në rast se nuk dilet në një konkluzion. Teorikisht ne mund të rekomandonim thirrjen e tij, pyetjen e tij, ripyetjen, për sjelljen e një dokumenti apo diçka tjetër. Kjo ishte arsyeja pse ne bëmë atë pyetjen e mëparshme.

Përfitoj nga rasti që të përsëris rekomandimin që Avokatja ka kërkuar me email. Mos do të ishte mirë që relacioni të shoqërohej dhe me një listë të dokumenteve? Ku është lista e dokumentave të dosjes së kandidatit? Ka një inventar të dokumentave të kandidatit gjithë dosjen. Kjo dosje besoj bëhet përpara se të hartohet relacioni apo jo? Do të ketë një listë bashkëngjitur relacionit.

Ardian Dvorani shpjegon se nëse ka një gjë që e relatojmë është procedura, të cilën e kemi përshkruar të plotë. Pastaj për problemin e kompletimit të dosjes e kemi rakorduar si do ta bëjmë dhe plotësojmë. Ju do të merrni dosje të kompletuar. Personalisht mendoj se nuk ka

nevojë për listë për momentin sepse dokumentat tregojnë veprimet pastaj sigurisht ato do të jenë të gjitha të listuara. Relatimet bëhen për të parashtruar procedurën e ndjekur dhe thelbin e gjetjeve. Ju, meqenëse e keni pozicionin e veçantë neve merrni dosjen e kompletuar. Tani të jap listë apo nuk të jap listë, ky është problem teknik, është tjetër gjë, por dosjen e ke të kompletuar. Këtu në relacion referohen dokumentat, nuk ka referime në ajër, por referimet janë me numra protokolli me data etj. etj., pra aty do ti kesh, nuk kemi ndonjë qasje për të mbyllur dhe fshehur ndonjë gjë.

Ardian Dvorani vijon me parashtrimin e relatimit për kandidaten Fiona Papajorgji për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Kuvendi në datën 28.08.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Fatjona Memçaj shprehet se një sqarim nevojitet, për periudhën , në shkronjën “ç” tek faqja 8. Përveçse punësimit si specialiste pranë Gjykatës Kushtetuese ka qenë edhe lektore e së drejtës. Për saktësim. Pra për periudhën mars 2009 mars 2011 përveçse ka qenë specialiste ka qenë edhe lektore e së drejtës.

Ardian Dvorani shprehet se e parashtrova më shkurt këtë moment, por edhe mund ta saktësojmë ndoshta më qartë në vendimmarrje.

Margarita Buhali pyet dhe kërkon të sqarohet se kur ka kandiduar kjo kandidate për vendin vakant?

Ardian Dvorani sqaron se në këtë vakancë ka kandiduar me shpalljen nga Kuvendi të vakancës në datën 28.08.2018. Sepse ka edhe dy kandidime të tjera

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se në pikën 18 thuhet që Prokuroria e Përgjithshme me shkresën numër aq e kaq ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit. Nisur nga periudha e gjatë rreth 8 vjet që kjo kandidate ka qenë jashtë shtetit ne si institucion do të donim të dinim nëse kjo njësia pranë Prokurorisë së Përgjithshme si është procedura dhe a kontakton me homologët në shtetet e tjera? Pra a e ka pasur për këtë mundësinë reale për vetë kohën e shkurtër kur është bërë ky lloj verifikimi? Edhe në debatin që patët ju pak më parë me z. Bici u shprehët që edhe në rastet e vendimeve të formës së prerë nëse ka një indicie, një dyshim KED-ja ka të drejtë që të rishikojë informacionet.

Ardian Dvorani shpjegon se kur plotësohet formulari i vetëdeklarimit, aty deklarohen të gjitha në detaje, pra edhe nëse ke aktivitet apo ke jetuar jashtë vendit. Se si e verifikon organi kompetent përkatës këtë gjë ai nuk na e shpjegon në përgjigjen e tij. Ai shprehet se

lidhur me formularin e vetëdeklarimit, nga kontrolli që është bërë kam këto përfundime. Për atë që di të paktën i drejtohen të gjithë prokurorive brenda republikës, por nuk jam kompetent për të të kënaqur me një përgjigje nëse e kanë verifikuar jashtë vendit. Kjo është një çështje që e dinë ata. Ne na vjen raporti përfundimtar dhe disponimi përfundimtar për kandidatin. Në rastin e vendimeve të formës së prerë të KPK, gjithsesi ne nuk i prezumuam të mirëqenë nga pikëpamja e integritetit. KED i përcolli kërkesat për informacione. Organet përkatëse e kanë përgjegjësinë e tyre për ti verifikuar periudhën përpara, të ndërmjetme, periudhën aktuale që sepse i kanë përpara listat dhe të dhënat. Me sa kam unë dijeni në përfundimet që dërgon Prokuroria e Përgjithshme, jo vetëm në këto raste të kandidimit, nuk shpjegon se ku i ka kryer verifikimet dhe çfarë informacionesh ka marrë, por jep përfundimet.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarin relatorë Fatjona Memçaj të raportojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Fiona Papajogji.

Fatjona Memçaj parashtron raportin për kandidatin Fiona Papajogji për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se ka të njëjtin qëndrim.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarin relator Fatri Islamaj të raportojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatës Fiona Papajogji.

Fatri Islamaj parashtron raportin për kandidatin Fiona Papajogji për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti në datën 04.03.2019.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtron se kemi të njëjtin qëndrim.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarin relatore Margarita Buhali të raportojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Altin Hazizaj.

Margarita Buhali, parashtron raportin për kandidatin Altin Hazizaj për vendin vakant të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se kam të njëjtin qëndrim.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastet e kandidimit të kandidatit Vladimir Gërmenji.

Eriol Roshi, parashtrohet relativisht për kandidatin Vladimir Gërmenji për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se kam të njëjtin qëndrim.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me shqyrtimin e gjetjeve në procedurat e verifikimit të disa kandidatëve të tjerë për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatore Arta Marku të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Vladimir Gërmenji.

Arta Marku, parashtrohet relativisht për kandidatin Vladimir Gërmenji për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se kemi të njëjtin qëndrim.

Ardian Dvorani i kërkon anëtarit relator Eriol Roshi të relatojë gjetjet për rastet e kandidimit të kandidatit Dedë Kasneci.

Eriol Roshi, parashtrohet relativisht për kandidatin Dedë Kasneci për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe shprehet se ka të njëjtin qëndrim.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatorë Arta Marku të relatojë gjetjet për rastet e kandidimit të kandidatit Dedë Kasneci.

Arta Marku parashtrohet relatimin për kandidatin Dedë Kasneci për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti me datë 07.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se nuk kemi qëndrim tjetër.

Ardian Dvorani i kërkon anëtares relatore Vitore Tusha të relatojë gjetjet për rastin e kandidimit të kandidatit Dedë Kasneci.

Vitore Tusha parashtrohet relatimin për kandidatin Dedë Kasneci për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi në datën 12.02.2018.

Ardian Dvorani pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë pyetje apo kërkesa për sqarime.

Enio Haxhimihali, si përfaqësues i Avokatit të Popullit dhe sipas procedurës për dhënien e mendimit lidhur me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidaturave merr fjalën dhe parashtrohet se nuk kemi asgjë për të shtuar.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës dhe deklaron mbylljen e mbledhjes.

MBYLLET MBLEDHJA NË ORËN 18.32

SEKRETARE

KRYETARI

Ermelinda KADIU

Ardian DVORANI

Redjona MYRTJA

Dorina DULAJ